


Analizë e titujve të themeluara në bazë gjinore:



Gjuha e urrejtjes seksiste

ndaj vajzave të reja

Analizë e titujve të themeluara në bazë gjinore:

Gjuha e urrejtjes seksiste

ndaj vajzave të reja

Publikues:

Instituti për studime komunikative
Rr. „Jurij Gagarin“ 17-1-1, Shkup
www.iks.edu.mk

Për publikuesin:

prof. i çregull. D-r Zhaneta Trajkoska

Edicioni:

ResPublica

Autorë:

m-r Bojana Jovanovska
m-r Jovana Jovanovska

Redaktor:

m-r Dejan Andonov

Përkthim nga gjuha maqedonase:

Vjosa Taipi

Titulli origjinal:

Анализа на родово-базирани содржини:
Сексистички говор на омраза кон млади
девојки

Dizajni grafik:

Igor Delov

Vendi dhe viti:

Shkupi, 2023

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

316.625:316.647.5-055.2-053.6:004.773.6/.7(497.7)“2023”(047.31)
364.634-055.2-053.6:004.773.6/.7(497.7)“2023”(047.31)

JOVANOVSKA, Bojana

Analizë e titujve të themeluara në bazë gjinore [електронски извор]
: gjuha e urretjes seksiste : ndaj vajzave të reja / Bojana Jovanovska,
Jovana Jovanovska ; [përkthim nga gjuha maqedonase Vjosa Taipi]. -
Превод на делото: Анализа на родово-базирани содржини : сексистички
говор на омраза кон млади девојки. - Shkup : Instituti për studime
komunikative, 2023

Начин на пристапување (URL):

<https://respublica.edu.mk/wp-content/uploads/2023/08/seksistichki-govor-na-omraza-kon-mladi-devojki-al.pdf>

- Текст во PDF формат, содржи 34 стр., илустр. - Фусноти кон текстот. -
Наслов преземен од екран. - Опис на изворот на ден 21.09.2023 год. -
Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4805-29-8

1. Jovanovska, Jovana [автор]

а) Говор на омраза -- Млади девојки -- Интернет социјални мрежи --
Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 61652485

Hyrje

Përmbajtjet që krijohen dhe shpërndahen në hapësirën online ende perceptohen kryesisht si të padëmshme, gjë që kontribuon në zhvlerësim të konsiderueshëm të ndikimit të tyre në botën fizike. Prandaj, shpërndarja e përmbajtjeve të pavërteta dhe me qëllim të keq, të cilat zakonisht janë shqetësuese për personat në shënjestër, ende trajtohet si fenomen që ndodh në izolim, në një botë “joreale” dhe si rezultat efektet e saj negative në botën “reale” amnistohen. Sjellja negative nuk njihet si një formë e dhunës ose gjuhës së urrejtjes dhe nuk adresohet në mënyrë përkatëse, gjë që inkurajon publikun të krijojë dhe të shpërndajë përmbajtje të reja që kanë një efekt negativ.

Liria e anonimitetit e ofruar nga mediat sociale ka krijuar një hapësirë që ka inkurajuar ndjeshëm njerëzit të shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre, por edhe të krijojnë përmbajtje të pavërteta dhe me qëllim të keq pa frikë nga përgjegjësia, përkatësisht pa pasur frikë se do të ndëshkohen. Ndërsa ngacmimi në internet ka qenë i përhapur që shumë kohë më parë, zhvillimi i mediave sociale si platforma publike për shpërndarje dhe konsumimin e informacioneve ka lejuar një shtrirje më të madhe, duke pasur parasysh shpejtësinë me të cilën përmbajtje të caktuara mund të përhapen në audiencë të mëdha. Në këtë mënyrë, ngacmimi i një personi të caktuar bëhet përmes online hapësirës publike, gjë që lejon mobilizimin e mbështetjes për përmbajtje shqetësuese dhe krijimin plotësues të përmbajtjeve të reja. Ky lloj ngacmimi mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme në gjendjen psikologjike dhe emocionale të personit të cilit i referohen këto përmbajtjeve, që, veçanërisht nëse bëhet fjalë për person të ri, mund të kenë efekte të përhershme në jetën dhe zhvillimin e tij të mëtejshëm, të përgjithshëm.

Sipas karakteristikave të veta, mediat sociale përfaqësojnë një terren pjellor për krijimin dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes me bazë gjinore dhe ngacmimit me bazë gjinore, më shpesh përmes përhapjes së vazhdueshme të stereotipeve gjinore në hapësirën online. Kjo është arsyeja pse mediat sociale

janë një nga instrumentet kryesore të fushatave kundër gjinisë, përmes të cilave përhapen dezinformata gjinore, por edhe përmes të cilave gratë sulmohen dhe linçohen në jetën publike, në mënyrë që të kufizojnë dhe dekurajojnë pjesëmarrjen e tyre në sferën publike.

Me rëndësi të veçantë për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve me qëllim të keq është roli i mediave dhe raportimi i tyre, duke pasur parasysh se postimet e raporteve gazetareske në mediat sociale më së shpeshti formojnë bazën për krijimin e këtyre përmbajtjeve, veçanërisht nëse ato nuk rregullohen nga mediat. Prandaj, qëllimi i kësaj analize është të identifikojë përmbajtjet keqdashëse dhe narrativet misogjiniste që synojnë vajzat e reja, të publikuara në komente të raporteve gazetareske në mediat sociale, si dhe të tregojë ndikimin e këtyre përmbajtjeve në perceptimin e stereotipeve gjinore. Qëllimi përfundimtar i kësaj analize është të kontribuojë në informimin dhe rritjen e njohurive dhe vetëbesimit të grave dhe vajzave për njohjen dhe trajtimin në mënyrë efektive të këtyre përmbajtjeve.

Kjo analizë, e titulluar “Gjuha e urrejtjes seksiste ndaj vajzave të reja”, është analiza e dytë e përmbajtjeve me bazë gjinore e përgatitur nga Instituti për Studime të Komunikimit në kuadër të projektit “Përdorimi i gazetarisë së bazuar në fakte për rritjen e ndërgjegjësimit dhe për kundërshtimin e dezinformatave në hapësirën mediatike në Maqedoninë e Veriut”, i cili zbatohet me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup.

Metodologjia

Fokusi kryesor i kësaj analize është përmbajtjet qëllimkeqe me bazë gjinore drejt vajzave të reja. Hulumtimi u krye me zbatimin e analizës cilësore të raporteve gazetareske dhe komentet në publikimet e raporteve gazetareske në mediat sociale (Facebook dhe Twitter), të publikuara në periudhën nga marsi deri në maj 2023. Kështu, qëllimi i kësaj analize është të identifikojë përmbajtjet keqdashëse dhe narrativet misogjiniste që synojnë vajzat e reja, të publikuara në komente të raporteve gazetareske në mediat sociale, si dhe të tregojë ndikimin e këtyre përmbajtjeve mbi perceptimin e stereotipeve gjinore.

Analiza përfshin përpunimin e dy rasteve studimore të bazuara në përmbajtje keqdashëse drejt vajzave të reja. Megjithëse të dy studimet merren me rastin e vajzave të zhdukura, pika fillestare në përzgjedhjen e rasteve për analizë nuk ishte sfondi i rastit, por përmbajtja e komenteve që ato shkaktuan në mediat sociale. Megjithatë, duke pasur parasysh se të dyja rastet, përveç temës së ngjashme, ndodhën njëra pas tjetrës, në një periudhë të shkurtër kohore, ato gjithashtu siguruan një bazë të mirë për krahasim, përkatësisht krijimin e relacioneve në lidhje me reagimet që shkaktuan. Studimi i parë përfshinte një analizë të një rasti të dy vajzave të mitura të zhdukura nga lagja Çair e Shkupit, ndërsa studimi i dytë i referohet dy vajzave të zhdukura në lagjen Qendër të Shkupit.

Për qëllimet e kësaj analize, u analizua një mostër prej 140 raportesh gazetareske dhe më shumë se 1.500 komente në mediat sociale në lidhje me dy studimet e rasteve. U analizuan raportet gazetareske nga të gjitha mediat online që raportuan për rastet që i nënshtrohen kësaj analize, pa përzgjedhje plotësuese të mediave individuale dhe komente mbi ato postime në mediat sociale. Duke marrë parasysh se fokusi i analizës ishte në komentet e mediave sociale, kryesisht në platformën Facebook, përmbajtja u analizua përmes disa aspekteve specifike:

- përdorimi i gjuhës sensacionale në publikime dhe raporte gazetareske nga mediat;
- përdorimi dhe përsëritja e vazhdueshme e stereotipeve gjinore në përmbajtjen e komenteve, dhe në veçanti përmes seksualizimit;
- përdorimi i gjuhës seksiste dhe gjuhës së urrejtjes;
- krijimi dhe përhapja e të pavërtetave;
- promovimi i kulturës së dhunës, veçanërisht dhunës me bazë gjinore;
- përgjegjësi për rastin dhe tendencë drejt maturimit.

Ndërkohë, në kuadër të analizës nuk janë përmendur inicialet që i referohen drejtpërdrejt identitetit të vajzave të mitura dhe nuk janë transferuar përmbajtje me fyerje të rënda dhe seksualizimin e tyre. Në kuadër të analizës, u përzgjodhën dhe u shënuan printskrin nga disa komente përkatëse, duke fshehur identitetin e krijuesve të tyre.

Konteksti i analizës

Shpërndarja publike e narrativeve misogjiniste përmes mediave sociale mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin personal dhe emocional të fëmijëve dhe të rinjve, por gjithashtu edhe të ketë pasoja afatgjata të dëmshme në favor të ruajtjes dhe thellimit të pabarazive gjinore në shoqëri. Këto narracione më së shpeshti verbalizohen në formën e përdorimit të përditshëm të gjuhës seksuale relativisht misogjiniste dhe të shëmtuar, kritikës së aktivitetit seksual të femrave, shakave për dhunën seksuale, akuzim të viktimave të dhunës me bazë gjinore, maturimit ose atribuimit të karakteristikave, përkatësisht, përgjegjësisë së të rriturve, të vajzave të mitura, objektivizimit dhe talljes së vajzave bazuar në pamjen e tyre, talljes së vajzave që kryejnë role gjinore jo stereotipike, etj.

Krijimi, shpërndarja dhe përhapja e përmbajtjeve me të cilat sulmohen persona të caktuar në bazë të gjinisë së tyre, përfshirë identitetin e tyre gjinor dhe orientimin seksual, përbëjnë dezinformim gjinor ose informacion të rremë, të cilat më së shpeshti karakterizohen nga mizogjia dhe homofobia.¹ Këto tregime mbështesin përsëritjen e stereotipeve gjinore në shoqëri dhe inkurajojnë dhunën me bazë gjinore si një instrument për ruajtjen e roleve tradicionale gjinore. Pikërisht miratimi dhe thirrja për dhunë ndaj grave është një nga shprehjet më të zakonshme dhe më të shpeshta të mizogjinisë.

Sipas fjalorit maqedonas, gjuha e urrejtjes me bazë gjinore dhe seksiste, e cila është një formë e dhunës në internet, i referohet çdo lloj komunikimi, përmes fjalës, tekstit ose sjelljes joverbale, që sulmon, poshtëron, fyen dhe diskriminon një person në bazë të gjinisë, seksit, orientimit seksual ose identitetit gjinor dhe, ndër të tjera, konsiston në turpërim dhe tallje seksuale.² Online dhuna përfshin format e ndryshme të dhunës në internet që kryhen me

1 IGF. (2021). *Exploring the concept of Gendered Disinformation*. Në dispozicion në: https://www.intgovforum.org/en/filedepot_download/62/20661

2 Vasileva, A., Martinoska, A. Dhe Milenkovska, S. (2023). *Fjalor dhuna me bazë gjinore e kryer me (keq) përdorim të teknologjisë*. UNFPA Në dispozicion në: https://mtspresursencentar.mk/publication/1993_poimnik_na_rodovo_baziranoto_nasilstvo_izvrsheno_so_zloupotreba_na_tehnologija_0.pdf

ndihmën e teknologjisë dhe përkufizohet si shkaktimi dhe përsëritja e qëllimshme e dëmit përmes kompjuterëve, telefonave celularë ose pajisjeve të tjera elektronike, zakonisht përmes përdorimit të përmbajtjes tekstuale ose grafike.³

Sipas hulumtimit, mediat sociale në mënyra të ndryshme krijojnë presion si tek vajzat ashtu edhe tek djemtë, ku ekspozimi ndaj online ngacmimeve ka efekt disproporcional mbi online aktivitetin të vajzave të reja, ku normat gjinore janë të përforcuara.⁴ Është vlerësuar se një në dhjetë gra të moshës mbi 15 vjeç përjetojnë online dhunë.⁵ Megjithatë, jo vetëm që gratë kanë më shumë gjasa të ekspozohen ndaj dhunës në internet, ato gjithashtu mund të vuajnë pasoja serioze fizike, psikologjike ose ekonomike.⁶ Për më tepër, ngacmimi mund të përkeqësohet kur kryhet në bazë të gjinisë në kombinim me faktorë të tjerë, duke përfshirë moshën, origjinën etnike ose racore, orientimin seksual, identitetin gjinor, aftësinë e kufizuar, etj.

Ballafaqimi me përmbajtje ofenduese dhe keqdashëse mund të shkaktojë frikë, ankth, stres, poshtërim dhe emocione të tjera negative tek ata që janë subjekt i këtyre përmbajtjeve. Ngacmimi i shkaktuar nga online përmbajtja mund të lërë trauma të përhershme për gratë dhe vajzat, ku kujtimi publik i turpit dhe fajit mund të çojë në brendësimin e traumës dhe të shkaktojë çrregullime të shëndetit mendor, që mund të shkojnë ankth, depresion, stigmë, deri te vetë-dëmtimi si një mundësi për ballafaqim me traumën dhe vetëvrasja si mënyra e vetme për t' i dhënë fund një traume të tillë.⁷ Të dhënat nga një sondazh i kryer në tre shkolla të mesme në Maqedoninë e Veriut treguan se 78% e të anketuarve ishin viktime të ngacmimit në hapësirën online, nga të cilët numri më i madh i grave dhe anëtarëve të komunitetit LGBTI, kategoritë që janë

3 Ibid.

4 EIGE. (2019). *Gender equality and youth: opportunities and risks of digitalization*. Në dispozicion në: <https://eige.europa.eu/publications-resources/publications/gender-equality-and-youth-opportunities-and-risks-digitalisation?lang=pl>

5 EIGE. (2017). *Cyber violence against women and girls*. Në dispozicion në: <https://eige.europa.eu/publications-resources/publications/cyber-violence-against-women-and-girls>

6 EIGE. (2022). *Combating Cyber Violence against Women and Girls*. Në dispozicion në: <https://eige.europa.eu/publications-resources/publications/combating-cyber-violence-against-women-and-girls>

7 University of Ljubljana. (2017). *Cyber Violence against Women & Girls REPORT*. Në dispozicion në: https://www.stoponlineviolence.eu/wp-content/uploads/2020/06/Cybersafe_Report_200623_web.pdf

viktimat më të shpeshta në hapësirën fizike.⁸ Megjithatë, ajo që është veçanërisht shqetësuese është se 11 të anketuar thanë se kishin mendime vetëvrasëse pasi iu nënshtruan këtij lloji të ngacmimit.

Pavarësisht nga ndryshimet midis vendeve dhe grup moshave, më shumë hulumtime sugjerojnë se shumica dërrmuese e përdoruesve të mediave sociale kanë hasur në ngacmime në platformën Facebook.⁹ Kjo gjithashtu tregon nevojën për rregullim të përmbajtjes me qëllim të keq që krijohet nga mediat, por shumë më tepër për ato që krijohen nga një audiencë më e gjerë, duke pasur parasysh efektet negative që mund të shkaktojnë këto përmbajtje, veçanërisht tek përdoruesit e rinj.

Për më tepër, gjuha e urrejtjes me bazë gjinore dhe dhuna me bazë gjinore në hapësirën online ende nuk njihen sa duhet nga institucionet përkatëse në Maqedoninë e Veriut. Përkundër përcaktimit të ngacmimit seksual në internet në Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe kriminalizimit të saj, ne ende përballemi me mosnjohjen dhe procedimin jo(adekuat) të saj. Gjuha e urrejtjes me bazë gjinore njihet nga Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi.

Lidhur me rregullimin e “gjuhës së urrejtjes” nga pikëpamja penale, disa vepra penale në Kodin Penal lidhen me gjuhën e urrejtjes, duke përfshirë: rrezikimin e sigurisë, shkaktimin e urrejtjes, mosmarrëveshjes ose intolerancës në baza kombëtare, racore, fetare ose ndonjë arsye tjetër diskriminuese, përhapjen e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemeve kompjuterike, aprovimin ose justifikimin e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës, diskriminimit racor ose të tjera. Megjithëse ky fenomen njihet në Kodin Penal në ekzistencën e disa veprave penale, nuk ka asnjë nen specifik që e kriminalizon drejtpërdrejt atë si një vepër penale të veçantë. E gjithë seria e keqkuptimeve dhe mangësive në kuadrin ligjor lidhet me mungesën e rregullimit të gjuhës së urrejtjes në hapësirën online. Një mungesë e tillë

8 Anastasovska, S. dhe Mitov, O. (2021). *Raport vjetor për gjendjen e gjuhës së urrejtjes në nivel lokal në qytetet Tetovë, Manastir dhe Shtip për vitin 2021*. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut. Në dispozicion në: <https://mhc.org.mk/reports/godishen-izveshtaj-za-sostojbata-so-govorot-na-omraza-na-lokalno-nivo-vo-gradovite-tetovo-bitola-i-shtip-za-2021-godina/>

9 University of Ljubljana. (2017). *Cyber Violence against Women & Girls REPORT*. Në dispozicion në: https://www.stoponlineviolence.eu/wp-content/uploads/2020/06/Cybersafe_Report_200623_web.pdf

reflektohet edhe në praktikën gjyqësore, ku hasim në ndjekje penale joefektive të autorëve dhe një numër dukshëm të vogël të dënimeve për gjuhën e urrejtjes. Kështu, për shembull, Sektori për Krim Kibernetik dhe Forenzikë Digjitale pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme është i vetmi institucion që ka qasje në mekanizmat për mbledhjen e provave në hapësirën online, por procedura për gjetjen e autorëve është e ngadaltë dhe shumica e procedurave marrin shumë kohë dhe përfundojnë me dështim. Për më tepër, nuk ka praktikë ligjore në Prokurorinë Publike për ndjekjen penale të gjuhës së urrejtjes në internet, gjë që potencialisht do të rriste rolin parandalues të ligjeve për të dekurajuar ata që abuzojnë me lirinë e fjalës në mediat sociale. Rrjedhimisht, ka mungesë të parandalimit të gjuhës së urrejtjes, sepse nëse një fenomen nuk njihet dhe nuk rregullohet, nuk mund të kemi të dhëna për seriozitetin e tij, pasojat që shkakton dhe nevojën për parandalim.

Me online media online nënkuptohen (forume, rrjete sociale dhe platforma të tjera që lejojnë shkëmbimin e lirë të informacioneve, ideve, pikëpamjeve dhe opinionëve) dhe çdo publikim tjetër të pavarur elektronik (blogje, prezantime në internet, etj.), përveç atyre të regjistruara në disa regjistra në përputhje me ligjin. Në rastin e fundit, mbetet në dëshirën e krijuesit të online - edicionit (blog, ueb faqe, etj.) nëse dëshiron ta regjistrojë atë edicion si një shërbim publik dhe ta konsiderojë si media për informim publik dhe t' i nënshtrohet legjislacionit të medias, ku në bazë të këtij statusi ai gëzon të drejta dhe detyrime të caktuara.¹⁰

Në Maqedoninë e Veriut sfera tradicionale mediatike e informimit publik rregullohet me Ligjin për media¹¹ dhe Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele¹². Edhe pse këto ligje nuk i rregullojnë mediat online, ka një numër ligjesh të tjera që i rregullojnë ato në një farë mënyre, duke përfshirë: Kodin penal, Ligjin për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje, Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, Ligjin për qasje të lirë në informata me karakter publik, Ligjin për

10 Baçoska, J. (2017). *Forcimi i standardeve profesionale ose erozioni i fjalës së lirë: Rregullimi i mediave online në Maqedoni*. Instituti për Studime të Komunikimit, Shkolla e Lartë e Gazetarisë dhe Marrëdhënieve me Publikun. Në dispozicion në: https://iks.edu.mk/attach/Regulacija-na-on_count-mediumi-rezime.pdf


11 Ligji për mediat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 184, datë 26.12.2013

12 Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 184, datë 26.12.2013

parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, Ligjin për marrëdhënie pune, Ligjin për materialin arkivor, Ligjin për tregtinë elektronike dhe të tjera.

Sa i përket mediave sociale, rregullimi i tyre është pothuajse inekzistent. Ndërsa mediat sociale kanë rritur mundësitë për lirinë e shprehjes, për shkëmbimin më të shpejtë dhe më të lehtë të informacioneve dhe për komunikim pa ndërprerje në nivel global, gjithashtu ka krijuar hapësirë për përhapjen e dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes. Në mediat sociale, gjuha e urrejtjes në vitet e fundit ka marrë hov dhe është një nga burimet kryesore të mizogjinisë dhe seksizmit. Ajo që është pozitive është se legjislacioni evropian është në hap me kohën dhe ka adresuar problemin e mos-rregullimit të mediave sociale që nga dhjetori 2018. Kjo do të thotë se Maqedonia e Veriut gjithashtu do të duhet të harmonizojë legjislacionin në fushën e platformave për shpërndarjen e videove dhe rrjeteve sociale, përkatësisht mediave sociale. Informacioni i fundit nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale është se ekspertët nga Komisioni Evropian tashmë janë duke punuar në harmonizimin e rregullores së mediave maqedonase me Direktivën e ndryshuar për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.¹³ Edhe pse kjo është një shenjë e mirë, aktualisht nuk ka rregullim të mediave sociale në vend, gjë që ka krijuar një vakum në të cilin zhvillohet gjuha e urrejtjes dhe përhapja e përmbajtjeve të dëmshme. Për më tepër, edhe pse mediat online janë subjekt i rregullimit në Ligjin për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje, i cili mbulon termin “publikime elektronike” si media përmes të cilave mund të kryhen fyerje dhe shpifje, kjo nuk vlen për gjuhën e urrejtjes.

13 MKD.mk. Erdhi koha për rregullimin e medieve sociale. Në dispozicion në: <https://www.mkd.mk/node/478487>



Studimi i rastit: **Vajzat e zhdukura në Çair**

Në kuadër të këtij rasti studimor, janë analizuar përmbajtjet lidhur me rastin e dy vajzave të mitura të zhdukura nga lagja Çair e Shkupit në fund të marsit 2023. Sipas raporteve të lajmeve që pasuan zhdukjen e dy vajzave dhe sipas raporteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, rasti përfshinte një vajzë 12-vjeçare dhe një 15-vjeçare që u larguan nga shtëpitë e tyre dhe nuk u kthyen. Denoncimi për vajzën 12-vjeçare është dorëzuar nga babai i saj në datën 30.3.2023 në orën 20.30, ndërsa denoncimi për vajzën 15-vjeçare është dorëzuar në të njëjtën ditë nga babai i saj në orën 22.00, të dyja denoncimet u bënë në stacionin policor Bit-Pazar. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, vajza 15-vjeçare është larguar nga shtëpia disa herë në të kaluarën dhe është kthyer përsëri. Në deklaratën e MPB-së, thuhet se po merren masa për gjetjen e personave.

Lajmet e para të publikuara në media i referoheshin vetëm zhdukjes së vajzës 12-vjeçare, me detaje të vajzës duke përfshirë emrin dhe mbiemrin, gjatësinë, pamjen, të gjitha të shoqëruara me fotografi, vendbanimin, shkollën, informacionin në lidhje me kohën e zhdukjes, detaje për denoncimet në polici dhe ndarjen e numrave të telefonit të kontaktit nëse dikush e vëren vajzën. Në

lajmet gazetareske, u shpërnda deklarata e babait të vajzës me një apel për ta ndihmuar gjatë kërkimit të vajzës. Në postimet e mëvonshme, në të njëjtën ditë, më 31.3.2023, filloi të ndahej informacioni për faktin se vajza 12-vjeçare u zhduk gjatë kohës që ishte në shkollë, ku u thirr gjatë orës mësimore nga një vajzë më e madhe dhe pas kësaj nuk u pa më. Edhe pse denoncimi për zhdukjen e vajzës së dytë, vajzës 15-vjeçare, është dorëzuar një orë e gjysmë pas denoncimit për zhdukjen e vajzës së parë, lajmi i referohet vetëm vajzës 12-vjeçare të zhdukur, me pretendimin se ajo është çuar diku nga një vajzë tjetër, e cila më vonë u raportua të ishte vajza 15-vjeçare. Lajmet gazetareske mbi rastin që nga fillimi përmbajnë detaje të emrave dhe mbiemrave të vajzave, disa detaje të jetës së tyre, lagjes në të cilën jetojnë, deklarata nga prindërit dhe njerëzit e afërt me ta.

Më vonë, lajmet gazetareske raportuan se grupi i tifozëve Shvercerët, u bënë thirrje anëtarëve të bashkohen me kërkimin për dy vajzat e zhdukura, ndërsa të nesërmen, më 1.4.2023, u shpërnda lajmi në shumë media se vajzat u gjetën në orën 13.30 në rrugën Xhon Kenedi, në një objekt shitës, në park, nga nëpunës policor, nga stacioni i policisë Bit Pazar.

Në kuadër të këtij studimi janë analizuar 80 lajme gazetareske të publikuara në mediat sociale në lidhje me rastin, si dhe mbi 700 komente në postimet e mediave sociale në gjuhën maqedonase dhe shqipe, kryesisht në Facebook. Nga analiza e lajmeve gazetareske, u vu re shpërndarja e të dhënave të hollësishme dhe fotografive të një vajze që është 12 vjeç, që mund të ndikojnë negativisht në jetën e vajzës dhe të shkaktojnë pasoja të dëmshme. Në pjesën më të madhe, titujt iu referuan seriozitetit të situatës dhe ndihmës së nevojshme për të gjetur vajzat. Nga analiza e komenteve, mund të vërehet një kohezion pozitiv i një numri të madh përdoruesish me qëllimin e vetëm për të ndihmuar në kërkimin e vajzave të zhdukura, por në të njëjtën kohë përmbajtje qëllimkeqe që kanë potencial të ndikojnë negativisht në jetën e mëtejshme të vajzave.

Shumica e komenteve që u analizuan përfshinin thirrje për ndihmë, thirrje për ndihmë nga Zoti, lutje dhe emotikone. Po aq shumë komente janë në drejtim të mbështetjes së familjes, shprehjen e simpatisë me prindërit dhe mesazhe për gjetjen më të shpejtë të vajzës ose vajzat të gjenden të shëndetshme dhe të gjalla. Një numër i madh komentesh kanë për qëllim dënimin e arsimtarit që

lejoj vajzën 12-vjeçare të largohet nga shkolla pasi u thirr nga vajza 15-vjeçare, e cila gjithashtu është zhdukur.

Додека во образование се вработува партиски ќе има вакви работи, за жал. Чест на исклучоци, но 90 % ем неписмено ем неодговорно. На сред час да пуштиш малолетно дете, а не е родител е малоумно, тотална негрижа. Дај боже да се најде девојчето живо и здраво.

Ми се допаѓа Одговори 12 седм.

205

Përkthim: „Derisa në arsim punësohen partiakisht do të ketë gjëra të këtilla për fat të keq. Ka edhe përjashtime, por 90% janë edhe analfabetë edhe të pa përgjegjshëm. Në mes të orës të lëshosh fëmijë të mitur, dhe të mos bëhet fjalë për prind është mendjelehtësi, pakujdesi totale. Dhëntë Zoti të gjendet vajza gjallë dhe shëndoshë.“

Madje komentet shkojnë deri atje që thonë se i gjithë vendi duhet të jetë nën mbikëqyrje në mënyrë që gjëra të tilla të mos ndodhin, dhe si shembull përmendet Turqia.

Vo Turska celat drzhava e pod nadzor na kameri .Hitno treba I kaj nas Prvo shkolite pa celiot grad da Se pod nadzor .Zatoa ovde se si seshto sev deshava kidnapiranja oshto ne grsbezhi palenje na objekti I vozila .A najstrasho evso ova so decatav koi izcheznuvaat

Ми се допаѓа Одговори 12 седм.

32

Përkthim: „Në Turqi i gjithë shteti është nën mbikëqyrje të kamerave. Urgjentisht duhet edhe te ne. Fillimisht shkollat, pastaj i gjithë qyteti të jenë nën mbikëqyrje. Prandaj këtu ndodh çdo gjë, kidnapime, vjedhje, djegie të objekteve dhe automjeteve por më e tmerrshme kjo që ndodhi me zhdukjen e fëmijëve.“

Disa nga komentet dënojnë prindërit dhe vajzat e zhdukura se bëhet fjalë për vajza të këqija, se meritojnë një dajak dhe se nuk janë edukuar mirë sepse vetëm vajzat humben, jo edhe meshkujt.

M.K qenka per ta lidh n'podrum, femija I keq

Ми се допаѓа Одговори Види го преводот 12 седм.

amon bre sall vajzat hupen nje her nuk psh djem te hupen

Ми се допаѓа Одговори Види го преводот 12 седм.



A thuper he lock jan tranu rinija ka vdek bablok kur bertitke flokt iriq duan te jetojn si eurpjan te knaqen te defrehen matura ka 4 dit qika djem po shka miba tik tokit qikan hup tru jan jan fshiii kejt

Ми се допаѓа Одговори Види го преводот 12 седм.

3

Komentet vunë në dukje përmbajtje që sugjeronin se vajzat nuk duhet të ecin vetëm gjatë natës dhe duhet të kenë më shumë kontroll mbi to. Faji për zhdukjen në këtë mënyrë i atribuohet mungesës së kontrollit mbi fëmijët femra dhe kontrollit që burrat kanë pasur në shtëpi në të kaluarën. Opinionet e tilla janë produkt i qëndrimeve patriarkale të ngulitura thellë që normalizojnë kontrollin mbi gratë dhe vajzat nga burrat, veçanërisht në komunitetet familjare. Për më tepër, përmes tyre, dhuna me bazë gjinore normalizohet si një mjet për vendosjen e kontrollit mbi trupat e grave. Në këtë kontekst, komentet fakt janë tregues i ndërgjegjësimit të ulët shoqëror të popullatës së gjerë dhe qëndrimeve ende të pranishme tradicionale, misogyniste ndaj grave, të cilat mund të çojnë vetëm në marginalizimin e mëtejshëm të grave dhe vajzave.

greota ..ama mislam deka otišla za organi .Koga im vikam na moive maloletni vnuki od brat kade setaat nokje vo 1 h ne sum loša tetka .tuku tetka koja mozebi i poveke misli od nivnite roditelji. Jas da imam cerka maloletna ne bi ja pustila so taksi noke da se vraća od grada I sekoj prav roditel ako e prav taka treba da postapi,bidejki ova vreme sega e ludo ,a I psihopati setaat po ulica ...Ne e ova vreme ona vreme koga mozeše da se spie i na klupa vo park a nikoj da ne te pipne,ne ova ona vreme koga slobodno mozeše da spies i na livada.Go traževte zapadot .eve go dojde i kaj nas.

Ми се допаѓа Одговори 12 седм.

15

Përkthim: „Gjynah por mendoj se ka shkuar për organe. Kur ju them mbesave të vëllait, të mitura se ku shëtisin natën në orën 1, nuk jam hallë e keqe por hallë që ndoshta mendon më shumë se prindërit e tyre. Unë të kem vajzë të mitur nuk do ta kisha lëshuar me taksi natën vonë në qytet... por edhe tani është çmenduri , psikopatë shëtisin rrugëve...Nuk është kjo kohë kur mund të flesh në bankë në park dhe askush mos të prekë, nuk është kjo kohë kur lirisht mund të flesh në një luadh. E kërkonit perëndimin, ja erdhi edhe tek ne.“

Në publikimet e lajmeve gazetareske në lidhje me përfshirjen e grupit të tifozëve “Shvercerat” gjatë kërimit, shumica e komenteve mirëpritën dhe respektuan masën dhe inkurajuan sa më shumë njerëz të jetë e mundur t’i bashkohen kërimit, pavarësisht nga besimi fetar dhe kombësia, duke kritikuar qeverinë dhe policinë, të cilat nuk tregojnë seriozitet të mjaftueshëm në kërkimin e vajzave.

Ne znam kade e mvr, zosto taa ne prevzema akcija, zosto gradjanite da se samoorganiziraat, za sto se plakaat policajci te, samo za kazni

Ми се допаѓа Одговори 12 седм.

11

Përkthim: „Nuk e di ku është MPB-ja, pse ajo nuk ndërmer aksion, pse qytetaret të vetë organizohen, pse paguhen policët, vetëm për dënime“

Përkundër komenteve që inkurajojnë përfshirjen e të gjithë njerëzve në kërkim, pavarësisht nga besimi fetar dhe kombësia, njëkohësisht ka komente dhe diskutimet nacionaliste që bëjnë defokusim nga problemi i vërtetë dhe serioziteti i situatës.

Kurse Shteti e Policia ne Gjum. Fmi te Shqiptarve se tishin kon Maqedonas apo Bugar ish Akrivizu edhe Ushtria

Ми се допаѓа Одговори Види го преводот 12 седм.

Siç u përmend, edhe pse zhdukja e dy vajzave ndodh njëkohësisht dhe pothuajse njëkohësisht zhdukjet raportohen në polici, lajmet e gazetarëve në pjesën më të madhe raportojnë vetëm për zhdukjen e të miturës 12-vjeçare. Vlen të përmendet se vetëm komentet e përdoruesve të Facebook-ut përhapin lajmin se të dy të miturat janë zhdukur dhe se në fakt mungon gjithashtu edhe vajza që ka thërritur vajzën 12-vjeçare nga shkolla. Kur kjo konfirmohet në media me fotografi dhe për të miturën 15-vjeçare, në komentet e lajmeve paraqiten spekulime për lidhjen e tyre. Në komentet e një raportimi gazetaresk në 4NEWS.mk me titull: *“Shvercerat” në orën 22 nga Skënderbeu fillojnë kërkim për x dhe y, u vërejt një koment se ndoshta bëhet fjalë për tantrum adoleshentësh dhe se njëra vajzë kishte një histori të ikjes nga shtëpia.*

Само да се живи и без трауми. Можно е да се избегани од дома. Едно од девојчињата имала историја на бегане од дома. Да се надеваме дека не се киднапирани и дека е тинејџерски “тантрум”. Ова би било најпивољното сценарио. 🙏

Ми се допаѓа Одговори 12 седм. Изменете

33


Përkthim: „Vetëm të jenë gjallë dhe pa trauma. Mund të kenë ikur nga shtëpia. Njëra nga vajzat ka histori të tillë që ka ikur nga shtëpia. Të shpresojmë se nuk janë kidnapuar dhe se bëhet fjalë për “tantrum” adoleshent. Ky do të ishte skenari më i favorshëm.“

Përveç këtij komenti, zhvillohet një diskutim i tërë, ku një nga komentet sugjeron se vajzat ishin të lidhura dhe se vajza më e madhe është lezbike, e cila shkon në shkollë me thikë dhe ikën nga shtëpia, se ajo ka rrëmbyer vajzën më të vogël. Komentet e mëposhtme janë spekulime se ajo që është shkruar është e vërtetë dhe se dikush i ka fotografuar së bashku dhe i ka raportuar në polici, dhe shpresojnë që policia do të diskutojë në lidhje me këtë me prindërit.

Përveç këtij diskutimi, pas gjetjes së vajzave, në të njëjtin konotacion shfaqen komente nëse dikush i ka pyetur ku ishin, shoqëruar me sharje dhe fjalë fyese që ishin së bashku dhe se ishin lezbike dhe donin të bënin gjëra të ndryshme. Spekulumet për orientimin seksual të vajzave ushqehen edhe më shumë nga

një postim i përbashkët që përshkruan rastin e zhdukjes jo si rrëmbim, por si një përpjekje për të shijuar lirinë larg familjeve të thyera dhe shtëpive të dy vajzave me orientim seksual të ndryshëm. Përveç kësaj, thuhet se transmetimi i lajmeve në media është manipulues, me qëllimin e vetëm për të fituar vëmendje dhe sensacionalizëm.

Arsyet e zhdukjes së vajzave mbeten të panjohura dhe janë të parëndësishme në çdo aspekt për publikun e gjerë. Por supozimet për zhdukjen e tyre dhe komentet që përmbajnë spekulime për orientimin seksual të vajzave, të cilat në thelb përhapin dhe intolerancën ndaj diversitetit, si dhe ato me fyerje dhe spekulime për qëllimet e këqija dhe sjelljen e keqe të vajzës më të madhe, mund të kenë një efekt serioz negativ në zhvillimin e vajzave dhe jetën e tyre të mëtejshme.



Studimi i rastit: **Vajzat e zhdukura në Qendër**

Në kuadër të këtij rasti studimor janë analizuar përmbajtjet lidhur me rastin e dy vajzave të mitura të zhdukura nga Strumica në qendër të Shkupit, në maj të vitit 2023. Në lidhje me rastin u publikuan disa lajme në mediat, sipas të cilave vajzat, të cilat erdhën në Shkup në një ekskursion njëditor shkollor, u panë për herë të fundit nga mësuesja e tyre para qendrës tregtare “Vero Jumbo” dhe duhej të bënin një shëtitje në një kohë të caktuar dhe të ktheheshin në vendin ku ishin parkuar autobusët, por ato nuk u paraqitën. Për më tepër, përpjekjet për t’i kontaktuar me telefon ishin të pasuksesshme sepse të dy vajzat kishin fukur telefonat e tyre. Rasti u raportua në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Shkup, prej nga doli deklaratë për shtyp se po merren masa për gjetjen e tyre, deklaratë e cila u shpërnda nga shumica e mediave. Njëkohësisht, apelet publike dhe numrat e telefonit ndahen në mediat sociale nga prindërit dhe të afërmit e vajzave për ndihmë në gjetjen e tyre.

Duke marrë parasysh se bëhet fjalë për persona të zhdukur, për të cilët kërkohet ndihmë për gjetjen e tyre, emrat, moshë dhe fotografitë e tyre janë publikuar në lajmet gazetareske. Shumë nga lajmet gazetareske përdorin terminologji sensacionale në raportimin e rastit, ku disa nga titujt dhe tekstet përsëriten,

kështu që ne hasim në disa raporte gazetareske me tituj identikë, siç janë: LAJMI I FUNDIT! MAQEDONIA NË KËMBË SONTE: Dy vajza nga Strumica janë të humbura në Shkup; FOTO: Kërkohen dy vajza që kanë humbur në Shkup, kishin ardhur për ekskursion nga Strumica; Policianë kërkim të vajzave të humbura nga Strumica të cilat u zhdukën në Shkup këtë pasdite.

Menjëherë pasi rasti u raportua për herë të parë, mediat ndanë pamjet dhe imazhet e një kamere vëzhgimi nga një strukturë pranë Vero Jumbo, e cila tregonte vajzat që ecnin në një rrugicë dytësore duke shkuar në drejtim të Pishinës olimpike. Më vonë, publikoheshin lajme gazetareske për intensifikim të kërkimit të vajzave të zhdukura, me një numër plotësues të pjesëtarëve të MPB-së. Vajzat u gjetën në orët e vona të mbrëmjes në lagjen Kisela Voda.

Studimi analizoi 60 lajmeve të publikuara në mediat sociale në lidhje me rastin, si dhe mbi 800 komente në postimet e mediave sociale, kryesisht në platformën Facebook, si dhe në Twitter. Përveç kësaj, postimet kanë më shumë se 4.000 shpërndarje dhe shënojnë angazhim të audiencës (engagement) prej mbi 9.000. Nga analiza e komenteve të mediave sociale në lidhje me lajmet gazetareske mbi rastin, mund të shihen disa aspekte. Në përgjithësi, shumica e komenteve kanë për qëllim shprehjen e mbështetjes për gjetjen më të shpejtë të vajzave dhe shkëmbimin e informacioneve në mënyrë që të ndihmojë. Megjithatë, në një pjesë të konsiderueshme të komenteve, përgjegjësia për situatën e ndodhur, kryesisht u referohen tre instancave: mësimdhënësit që ishin përgjegjës për nxënësit në ekskursion, prindërit e vajzave dhe vetë vajzat. Pikërisht disa nga këto komente përfshijnë fyerje dhe fjalë misogyniste dhe janë bazë për zhvillimin e diskutimeve të mëtejshme në mbështetje të këtij narracioni negativ.

Shumë nga komentet përqendrohen në (mos)përgjegjësinë e prindërve të vajzave, përkatësisht problemin e kërkojnë në edukimin e tyre shtëpiak dhe te vetë vajzat, gjë që tregon normalizimin e kontrollit të sjelljes së grave dhe vajzave përmes komuniteteve familjare, më shpesh përmes një forme të dhunës me bazë gjinore. Pothuajse në çdo publikim të një lajmi gazetaresk për të cilin ka reagime të shumta (për shembull, postimet e Fokusit¹⁴, Strumica denes¹⁵,

14 Në dispozicion në: https://www.facebook.com/615792920552798/posts/706223801509709?paipv=0&eav=Afbk2k8YQguIvVYeztvW88qSK9Zzb7490ceou-cI5ARR2eHxiNRHGr7Qg-KbZs2GW3k&_rdc=2&_rdr

15 Në dispozicion në: https://www.facebook.com/627496366057072/posts/653090966830945?paipv=0&eav=AfZfzBG10B3fkreUIIdTK6f7WwJEUITMX789kkD8SjzPZyrDqSz-6CiGUWe8rUVsfC-w&_rdc=2&_rdr

A1on.mk¹⁶) ka komente që fajësojnë vajzat për sjelljen e tyre të papërshtatshme dhe të papërgjegjshme. Shumica e komenteve me përmbajtje keqdashëse shfaqen pas publikimit të videove dhe imazheve të kamerave të mbikëqyrjes në të cilat duket se vajzat flasin në telefon, dhe bazuar në sjelljen e tyre brenda atyre pak sekuencave, bëhen supozime për zhdukjen e tyre dhe lindin dyshimet e para në lidhje me shkaqet e zhdukjes. Prandaj, në shumë prej komenteve, shprehet dyshimi se vajzat mund të kenë fikur qëllimisht telefonat, por se nuk i kanë kërkuar askujt ndihmë dhe udhëzime ose një telefon për të thirrur ose raportuar në polici.

Na snimkata izgleda bas točno kako da znaat kade odat a ne kako da se izgubeni bidejki ako se uzgubea ke prasaa nekoj na kade da se upatat.

Like Reply 5w



Përkthim: „Në inicim duhet sikur pikërisht dinë ku shkojnë, jo sikur janë humbur, sepse nëse janë humbur do të pyesin dikë për udhëzime.“

moe mislenje sigurno se dopisuvale so nekoj i kazale deka ke odat za sk aj da se videme tam i tam i se gubi traga inaku i tel da se iskluci ke gi usluzi nekoj ako se izgubat policija na sekoja ulica sami ke se prijavat

Like Reply 5w



Përkthim: „Mendimi im është se sigurisht janë shkruar me dikë dhe i kanë treguar se do të shkojnë në Shkup, të shihemi në filan vend, u humbet gjurma, përndryshe edhe telefoni tu jetë fikur do tu kishte ndihmuar dikush nëse humben, polici ka në çdo rrugicë, vetë do të paraqiten“

Komentet zhvillojnë diskutime përmes analizës së veprimeve të vajzave dhe formulojnë supozime, të cilat gjithashtu përmbajnë fyerje të drejtpërdrejta të drejtuara ndaj tyre. Kështu, në komente pretendohet se ato padyshim ishin në humor të mirë kur u ndanë nga grupi, se e dinin saktësisht ku po shkonin, se tashmë kishin një plan dhe ishin marrë vesh të takohen me dikë. Kështu, sjellja e tyre dënohet, duke qenë se shqetësojnë prindërit e tyre, por edhe të gjithë qytetarët.

Ovie znaele kade odat i sega ucitelkata im e kriva. Golemi se i znaat da se krijat, imale nekoj plan. Ajde ke gi najdete vo nekoj park kako sedat po završenata misija.

Like Reply 5w Edited



Përkthim: „Këto e kanë ditur ku shkojnë dhe tani mësuesja është fajtores. Të mëdha janë dhe dinë të fshihen, kanë pasur ndonjë plan. Hajde do t'i gjeni në ndonjë park të ulura dhe misioni i kryer.“

16 Në dispozicion në: https://www.facebook.com/281596268582644/posts/6126607680748111/?paipv=0&eav=AfYXdsX36NJl4t8GPM6jc4bMub30LDtNeGsBIOGdNrCmcNw4gAtbmoqE8NraAW1P1vI&_rdc=2&_rdr

ova planirano napustanje na grupata ,setanje na dve guski vo magla koi sigurno imale telefoni cela drzava ja voznemirija,odgovornost i kazna a za roditelite povekje da rabotat so decata

Like Reply Sw



Like Reply Sw

zaminale negde vbiblioteka sigurno 😊

Like Reply Sw

Top fan

Nese devojcina tuku Magarici otise po skopje na Boli zivot

Like Reply Sw

Oni pred da odat se dogovorile so nekoj na fb ili telefonski ima raznorazni

Like Reply Sw

10

kako ne

Like Reply Sw

videte prvo kakvi se nepoznati prijateli imat pa posle sekoj ne e za prijatel na fb

Like Reply Sw

pa toa deca se sepak

Like Reply Sw

deca se Ama od toa dopustanje neli gledas so se slucuva u Srbija od takvi samo

Like Reply Sw

ama THIS IS SPARTA

Like Reply Sw

точно така.
Де се изгубиле учителката е крива не е никој крив
Самите се криви и родителите.

Like Reply Sw

2

Përkthim: Kjo braktisje e planifikuar e grupit, shëtija e dy sorrave në mjegull të cilat sigurisht kanë pasur telefona, gjithë shtetin e shqetësuan, përgjegjësi dhe ndëshkim për prindërit të punojnë më shumë me fëmijët.

- Sigurisht kanë shkuar në bibliotekë :)
- Nuk janë vajza po gomarica, kanë shkuar në Shkup për jetë më të mirë
- Ato para se të shkojnë janë marrë vesh me dikë në fb ose telefon...
- Shikoni fillimisht sa miq të panjohur kanë, çdo person nuk bëhet mik në fb

- Megjithatë janë fëmijë
- Fëmijë janë por nga lazdrimi i tyre apo shikon çfarë ndodhi në Serbi
- Ama THIS IS SPARTA
- Nëse janë humbur mësuesja është fajtorë, askush tjetër. Vetë prindërit janë fajtorë.

Ajo që është e rëndësishme është se disa komentatorë e anashkalojnë plotësisht faktin se këto janë vajza të mitura në një qytet që ata (ndoshta) nuk e njohin mirë, gjë që është veçanërisht e dukshme përmes komenteve që pretendojnë se nuk janë fëmijë të vegjël, si dhe komente me të cilat janë fyer dhe seksualizuar, madje lidhen me prostitucionin, trafikimin e qenieve njerëzore dhe të ngjashme.

vo pravo si, znaeme dovolno za zarabotkata na brza para, cena za pola cas, za eden cas ... komplet, polovicno ... nema shansi da se izgubile, ne se prvacinja ?

Like Reply 5w

Përkthim: “ke të drejtë, dimë shumë mirë për fitimin e parave të shpejta, çmimi për gjysme orë, për një orë...komplet, gjysmë...nuk ka shanse të jenë humbur, nuk janë klasa e parë?”

Hajt sejon nzhurka per nja 2 dit dot kthehen se nukan hup mosubani merak per nja 2.3 dit dot kthehen ktupari jan

Like Reply 5w

Komentet gjithashtu sugjerojnë se vajzat ishin humbur qëllimisht në mënyrë që të ishin në qendër të vëmendjes dhe të bëheshin të famshme, me rrjetin social TikTok që përmendet në disa raste.

duhet me mshel Tiktok'i se u prish mileti ej

Like Reply 5w Edited

Nëpërmjet këtyre përmbajtjeve, konfirmohen disa stereotipe dhe paragjykime gjinore që ende ekzistojnë në shoqërinë tonë, ku sjellja e grave shoqërohet me nevojën për vëmendje dhe seksualizimi i tyre bëhet për hir të fyerjes së personalitetit dhe veprimeve të tyre.

Në disa nga komentet që kërkojnë përgjegjësi nga mësuesit, madje zhvillohen diskutime në mbrojtje të tyre, duke e hedhur përgjegjësinë tërësisht tek dy vajzat dhe qëllimet e tyre të fshehura me veprimet e tyre.

██████████ a kakva nevospitanost od doma od roditelite i nepoćit kon nastavnicite maloumni se pa so telefonite se dvojat od drugite najpametni se tie dve ili došle dečkovci da baraaaat ne baraj i ne pišuvaj gospogo protiv nastavnicite do roditelite i decata e taaa ne gi ostavila ne zbori gluposti

Like Reply 5w



Përkthim: “çfarë mos edukate nga shtëpia, nga prindërit dhe mos respekt ndaj mësimitdhënësve, mendjelehta me telefon janë dhe ndahen nga të tjerët, më të mençura janë këto ato dy vajza ose kanë ardhur të kërkojnë të dashur, mos kërko dhe mos shkruaj zonjë kundër mësimitdhënësve, është fajti i prindërve dhe fëmijëve, mësuesja nuk i ka lëshuar, mos fol budallaqe”

Не се на богато семејство со врски како тие вагабонтките што беа што ги бараа и хулигани и дилери на дрога и министерства и што ти уште не (а на крај излезе избегани биле од дома кога ги најдоа за неполни два дена), па затоа не им е гајле на надлежните. А да, исто и етнички македонки се, не се малцинство, така да нема политички поени тука да ги бараат, никој не го боли уво за македонците.

Like Reply 5w Edited



Përkthim: “Nuk janë të familjes së pasur, me lidhje si ata vagabondë që ishin, që i kërkonin dhe huliganë dhe shpërndarës të drogës dhe ministritë dhe që ata ende nuk (dhe në fund doli se kanë ikur nga shtëpia kur i gjetën për dy ditë jo të plota) prandaj nuk mërzhiten për kompetentët. A po, gjithashtu janë maqedonase etnike, nuk janë pakicë, kështu që nuk ka pikë politike këtu që t’i kërkojnë, askush nuk mërzhitet për maqedonastit”

Për më tepër, në komente ka fyerje ndaj vajzave me arsyetimin se ato vijnë nga një provincë, dhe në të njëjtën kohë bëhet një krahasim me rastin e vajzave të zhdukura në Çair, veçanërisht në baza etnike.

Siç u përmend, disa nga komentet që dënojnë sjelljen e vajzave përgjegjësine për rastin e hedhin te prindërit e tyre dhe edukimin joadekuat të vajzave.

Раскалашеноста на децата од страна на родителите- ефектот е дрско , неодговорно однесување

Like Reply 5w





Përkthim: “Lazdrimi i fëmijëve nga prindërit –efekti është sjellje arrogante”

Kade be izgubeni so telefoni vraka shetkarat taka gi vaspita od doma nif koga ke se vratat doma ubavo peglajne i shishajne nularica stramota ova shto go praat si gi voznemiruvat roditelite familijata i red drugi .

Përkthim: “Ku janë humbur me telefona në dorë, shëtisin, kështu i kanë edukuar nga shtëpia ato, kur të kthehen në shtëpi një dajak të mirë dhe qethje zero, turp këtë që po e bëjnë, i shqetësojnë prindërit, familjet dhe të tjerë”

Përveç kësaj, në kuadër të komenteve ndahen leksione për prindërim dhe inkurajohet në mënyrë eksplicite që vajzat të ndëshkohen nga prindërit sapo të kthehen dhe duke stimuluar forma të ndryshme të dhunës. Përveç komenteve, mund të gjenden ide të ndryshme për dënimin e duhur të vajzave, të cilat, përveç prindërve, duhet të zbatohen edhe nga ata që janë përgjegjës në shkollë, si marrja e telefonit, puna e detyruar, ulja e notave, ndalimi i ekskursioneve dhe të ngjashme.



Përkthim: “Këta sot nuk janë fëmijë, janë dreqër cccc pa tru, e shqetësojnë gjithë shtetin, plus telefonat e fikur dhe shëtisin të qetë, abre qotek vetëm, si më parë që ishte, pa të shohim a do guxojnë të ndahen nga grupi dhe të ikin në kokë të tyre...Prindër ku keni vetëdijen çfarë prisni? A dini si të edukoni fëmijët ose vetëm dini të dremisni në telefon gjithë kohës, ndërsa fëmijët le të bëjnë çfarë të duan, duhet punë dhe bisedë me të gjithë fëmijët, vetëdijeshuni!!

- Saktë dhe nga një sanksion për prindërit, sepse fëmijët e tyre nuk janë të urtë, le t’i këshillojnë dhe ndëshkojnë në shtëpi ose le t’ua sjellin mendjen taket e forta, do të shëtisin ato vetëm nëpër Shkup, a i kishin çuar në vero, t’ua marrin telefonat dhe drejt në psikolog...

- Mendoj se prindërit janë “dreqër” më të mëdhenj, sepse prej tyre vjen çdo gjë edhe edukimi, këshillimi... kur je prind përgjigjesh për fëmijët tënd

- Meritojnë një qotek të rëndë nga prindërit, si në kohën, më parë.

- saktë, pikërisht tani po shkruaja si ishte në kohën tonë, në Jugosllavi.”

Shumë nga këto komente përdorin të ashtuquajturën në kohën time- narrative, përmes së cilës autorët bëjnë një krahasim me sjelljen dhe edukimin e fëmijëve në kohën kur ata rriteshin dhe mjetet disiplinore të përdorura si të përshtatshme për të shmangur këtë lloj sjelljeje të demonstruar nga fëmijët e sotëm. Kështu, shumica e këtyre komenteve mbështesin përdorimin e dhunës fizike, si nga prindërit ashtu edhe në shkolla.

imale ama gi isklucile mobilnite telefoni ne bile dostapni..
Abe ova ne se deca Sega, vo moe vreme se znaese kade odat site tamu i nie vo grupa zaedno i nema oddalecuvanje nikako, bevme poslusni i odgovorni deca, vospitani doma od roditelite na strog nacin i niti e imalo izgubeni deca, niti tepacki a ova sto e Sega, od ligavo po ligavo na praveno dete, dozvoleno e se za niv i pravat gluposti samo i jas sum roditel na 16 god momce i e vospitano na toj nacin kako sto sum vospitana i jas od moite roditeli nema opravduvanje za ova denes sto go napravile..

Like Reply 5w Edited

53

па нормално дека ќе ги исклучат телефоните инаку како ќе им започне забавата ако се достапни абее за овие пусто турско

Like Reply 5w

11

Treba kjotekot po skolite da se vrati.

Like Reply 5w

34

definitivno

Like Reply 5w

5

treba prvo doma pa posle kjotek po skolite. Nemat domashno vospituvanje i zatoa se slucuvaat takvi gluposti i gi baraat po internet izgubeni slucai

Like Reply 5w

5

Jas 37god,rodена vo Skopje nemam pominato vo tie ulicki kade 90% se stari luge vo kukjite oni od Bosilovo trgnale.Posleden povik i ke gi najdat ama denesnava mladina e poveketo lesnoumna kojznae koj se gi podlazal,se se dolzi na internetot tie tik - tok s*anja i sl.U nase vreme kjutekot od rajot ni vikaa pa ne smeevme da mdneme sega od 10 god Skopje napreko i popreko go setaat.Nikomu ne posakuvam vakvo nesto skraja bilo i lesno e da solime pamet tesko na roditellite ama treba mnoguuiu zborenje so decata pogotovo so pubertetlii.

Like Reply 5w Edited

70

Përkthim: kanë pasur por i kanë fikur telefonat celular. Këta tani nuk janë fëmijë, në kohën time dihej, ku shkonin të gjithë atje edhe ne në grup së bashku dhe nuk mund të largoheshim assesi, ishim të dëgjueshëm dhe fëmijë përgjegjës, të edukuar në shtëpi nga prindërit në mënyrë të rreptë dhe as ka pasur fëmijë të humbur, as rrahje, kjo tani çfarë është, nga qaraman më qaraman fëmijë, për ata lejohet çdo gjë dhe bëjnë marrëzira, edhe unë jam prind i një fëmije 16 vjeç mashkull, ai

është i edukuar në mënyrën si jam edukuar unë nga prindërit e mi, nuk ka arsyetim për këtë që e kanë bërë sot.

- Duhet të kthehet qoteku nëpër shkolla.

-Fillimisht duhet në shtëpi pastaj qotek në shkolla. Nuk ka edukim shtëpiak, prandaj ndodhin marrëzira të këtilla dhe i kërkojnë nëpër internet raste të humbura.

Unë 37 vjeç e lindur në Shkup, nuk kam kaluar nëpër ato rrugica ku 90% janë njerëz të moshuar në shtëpizat, ato nga Bosillova paskan shkuar. Thirrje e fundit dhe do t'i gjejnë ama rinia e sotme shumica janë mendjelehtë kushedi kush i ka gënjer, gjithçka është për shkak të internetit, tik-tok m*t dhe ngjashëm. Në kohën tonë thuhej dajaku nga xheneti ka dalë dhe nuk guxonim të lëvizim, tani nga 10 vjeç shëtisin Shkupin gjerë e gjatë. Askujt nuk i dëshiroj një gjë të tillë, Zoti mos e dhëntë, është kollaj t'u shesim mend prindërve por duhet shuumë të bisedohet me fëmijët, aq më tepër me fëmijët në pubertet.

Ajo që është shqetësuese është se këto komente gëzuan mbështetje nga një audiencë më e gjerë, e shprehur përmes numrit të pëlqimeve dhe komenteve. Mbështetja për përdorimin e dhunës si mjet disiplinor justifikon dhunën me bazë gjinore në raste të caktuara, domethënë kur *qëllimi justifikon mjetet*. Në këtë mënyrë, këto narrative kontribuojnë në normalizimin e dhunës me bazë gjinore në shoqëri dhe përsëritjen e saj, si dhe njohjen joadekuate, si nga vetë viktimat ashtu edhe nga institucionet në atë shoqëri.

Pavarësisht nëse ndonjë nga supozimet për zhdukjen e vajzave është i saktë, këto përmbajtje mund të kenë një efekt serioz negativ në zhvillimin e vajzave, duke pasur parasysh se ato janë vajza të mitura që ofendohen publikisht, gjykohen dhe seksualizohen.

Diskutim përfundimtar

Për të analizuar përmbajtjen e komenteve, baza ishte publikimi i lajmeve gazetareske në mediat sociale, nga të cilat mund të shohim **përdorimin e gjuhës sensacionale në titujt e lajmeve**. Nëse konsiderojmë se audiencia në mediat sociale shumë shpesh i bazon komentet e saj pikërisht në tituj, dhe një pjesë nuk e lexon fare raportin gazetaresk, sensacionalizmi në tituj mund të ndikojë në nxjerrjen sipërfaqësore të përfundimeve nga lexuesit. Përveç kësaj, për shkak se bëhet fjalë për persona të zhdukur për të cilët kërkohet ndihmë që të gjenden, raportet e shtypit publikojnë emrat, moshën dhe fotot e vajzave të mitura.

Shumica e komenteve të analizuara në raportet e lajmeve kanë për qëllim shprehjen e mbështetjes për gjetjen sa më të shpejtë të vajzave, bashkëndjenjen me prindërit e vajzave dhe shkëmbimin e informacionit në mënyrë që të ndihmojnë në kërkim. Megjithatë, në një pjesë të konsiderueshme **të komenteve, fokusi është në përgjegjësinë për situatën, domethënë “fajtorët” për zhdukjet**. Kërkesa për llogaridhënie drejtohet në tre instanca kryesore: mësuesit që ishin përgjegjës për nxënësit në ekskursion, prindërit e vajzave dhe vetë vajzat. Përveç kësaj, kërkohet përgjegjësi edhe nga policia për një kërkim më efektiv. Nga këto përmbajtje fillon vala e fyerjeve dhe gjuhës së urrejtjes dhe ato janë baza për zhvillimin e diskutimeve të mëtejshme për të mbështetur këtë narrativë negative.

Ekziston një model mjaft i qartë në mënyrën e krijimit të narrativës në përmbajtjen e komenteve, në të cilat në të dy rastet zhvillohen diskutime në të cilat bëhet analizë e veprimeve të vajzave dhe **formulohen supozime për arsyet e zhdukjes së tyre**. Kështu, **këto komente bazohen vetëm në supozime dhe spekulime personale**, të cilat nga ana tjetër janë të mjaftueshme për të provokuar imagjinatën e audiencës dhe për të konceptuar tregime të ndryshme misogyniste. Përmes këtij trendi, ne mund të shohim qartë **prirjen e një pjese të madhe të audiencës për rrëfime që bazohen në stereotipe**

gjinore përsëritëse, veçanërisht përmes mbështetjes së gjerë të këtij lloji të përmbajtjes.

Në një nga rastet, ka **supozime në lidhje me orientimin seksual të vajzave, të cilat ishin një nxitje e mjaftueshme për një seri komente homofobike dhe paragjykime**. Në këto komente nuk mbeti pa u vënë re dhe toni i dhunshëm për të cilin përvoja tregon se, veçanërisht **kur bëhet fjalë për urrejtjen për shkak të orientimit seksual, ka tendencë të nxisë dhe të rezultojë në dhunë**. Këto spekulime mund të dëmtojnë seriozisht dy vajza të tilla të reja, dhe veçanërisht nuk duhet të neglizhohet interseksioni me përkatësinë e tyre etnike dhe mjedisin në të cilin jetojnë, që tregon për një **shkallë të lartë të intolerancës ndaj diversitetit në shoqëri**.

Në disa nga përmbajtjet, mund të vërehet një tendencë për matrikullimin e vajzave nga komentatorët, domethënë një neglizhencë e plotë e faktit se ato janë të mitur, veçanërisht në rastin e vajzave të zhdukura në Qendër, të cilëve u **atribuohet përgjegjësi e plotë për zhdukjen, e cila më pas shërben si bazë për fyerjen dhe seksualizimin e tyre**. Në këtë mënyrë, ka një vazhdimësi të stereotipeve të caktuara gjinore përmes të cilave gratë, të cilës do moshë, seksualizohen për shkak të fyerjes së personalitetit dhe veprimeve të tyre, si dhe paragjykimet se veprimet e grave janë të lidhura drejtpërdrejt me nevojën për vëmendje, veçanërisht në rrjetet sociale.

Përveç kësaj, për të korigjuar sjelljen e papërshtatshme të vajzave, në komente ndahen **leksione të shumta mbi prindërimin dhe format e ndëshkimit, në pjesën më të madhe duke stimuluar dhunën**. Faji në këtë rast i atribuohet kontrollit të pamjaftueshëm mbi fëmijët femra, i cili është produkt i qëndrimeve patriarkale të rrënjësura thellë, të cilat e bëjnë të pranueshme kontrollin mbi gratë dhe vajzat, kryesisht nga burrat, në komunitetet familjare. Në të njëjtën kohë, **mbështetja nga audienca më e gjerë për ushtrimin e dhunës, veçanërisht fizike, si masë disiplinore, e cila shprehet përmes numrit të pëlqimeve dhe komenteve, paraqet një shqetësim i veçantë**.

Në këtë mënyrë, duke mbështetur në mënyrë eksplicite ushtrimin e dhunës, ajo ndikon në **ruajtjen e një kulture të dhunës me bazë gjinore në shoqëri**, brenda së cilës dhuna shërben si një mjet për ruajtjen e rendit tradicional gjinor. Në këtë kontekst, përmbajtjet janë tregues i ndërgjegjësimit të ulët

shoqëror të popullatës së gjerë dhe qëndrimeve ende të pranishme tradicionale, misogjiniste ndaj grave, të cilat mund të çojnë vetëm në **margjinalizimin e mëtejshëm të grave dhe vajzave**. Përveç kësaj këto **narrative kontribuojnë në normalizimin e dhunës me bazë gjinore në shoqëri dhe përsëritjen e saj**, si dhe njohjen joadekuate, si nga vetë viktimat ashtu edhe nga institucionet në atë shoqëri.

Duke marrë parasysh se kjo analizë u përgatit disa muaj pas ngjarjeve që ishin objekt i studimit, dhe u analizuan më shumë se 1.500 komente mbi raportet e lajmeve, mund të shohim se një pjesë e madhe e **mediave nuk kanë politikë të rregullimit të përmbajtjes së komenteve në postimet e tyre, përmes fshehjes ose fshirjes së përmbajtjeve me gjuhë urrejtjeje, fyerje dhe përmbajtje të tjera të dëmshme**. Në këtë mënyrë, mediat kontribuojnë në përhapjen e këtyre përmbajtjeve dhe lejojnë mobilizimin e mbështetjes për përmbajtje shqetësuese dhe krijimin shtesë të përmbajtjeve të reja.

Duke pasur parasysh të gjitha pasojat e mundshme negative të këtij lloji të përmbajtjes jo vetëm për vajzat e zhdukura, por edhe për të gjitha vajzat dhe gratë në shoqëri, është e nevojshme që këto vepra të njihen nga institucionet përkatëse dhe krijuesit e këtyre përmbajtjeve të sanksionohen në mënyrë të përshtatshme.

Në të dy rastet që kanë qenë objekt i analizës, nëse ndonjë nga spekulimet e deklaruara në lidhje me shkaqet e zhdukjeve është i saktë, **këto përmbajtje mund të kenë një efekt serioz negativ në zhvillimin dhe jetën e mëtejshme të vajzave, duke pasur parasysh se ato janë vajza të mitura që nënçmohen publikisht, dënohen dhe seksualizohen**. Shënime përfundimtare

Duke marrë parasysh analizën e përmbajtjes së dy rasteve studimore dhe argumentet e cituara në diskutimin përfundimtar, mund të nxjerrim disa pikëpamje kryesore në lidhje me përmbajtjet qëllimkeqe dhe narrativet misogjiniste:

- duke pasur parasysh se mediat përdorin gjuhë sensacionale në titujt e raporteve gazetareske, gazetarët duhet të jenë të kujdesshëm në formulimin e titujve, veçanërisht kur bëhet fjalë për raste të ndjeshme,

pasi kjo mund të ndikojë në nxjerrjen sipërfaqësore të përfundimeve nga lexuesit;

- përmbajtja e komenteve përqendrohet kryesisht në kërkimin e përgjegjësisë, përkatësisht “fajtorin” për situatën, e cila është baza për zhvillimin e diskutimeve të mëtejshme dhe zhvillimin e një narrative negative;
- diskutimet rreth veprimeve të vajzave formulojnë supozime rreth arsyeve të zhdukjes së tyre, të cilat bazohen vetëm në mendime dhe spekulime personale, të cilat janë të mjaftueshme për të provokuar imagjinatën e audiencës dhe për të konceptuar narrative të ndryshëm misogynist. Në drejtim të transformimit të këtyre modele të menduarit, të cilat janë bazë për krijimin dhe përhapjen e dezinformatave, është e nevojshme të bëhet informimi i vazhdueshëm i publikut të gjerë, veçanërisht i popullatës së re, për njohjen dhe parandalimin e ndikimit të tyre negativ dhe shpërndarjes së mëtejshme;
- ka një prirje në mesin e audiencës për narrativa që bazohen në stereotipe gjinore dhe i përforcon ato, veçanërisht përmes mbështetjes së gjerë për këtë lloj përmbajtjeje. Kjo bazohet në tendencën për të maturuar vajzat, domethënë duke neglizhuar plotësisht faktin se këto janë të mitur, të cilëve u atribuohet përgjegjësi e plotë për zhdukjen, e cila shërben si një nxitje për të ofenduar përmes seksualizimit të tyre, i cili bazohet në paragjykimin gjinor. Kjo tregon për ndikimin ende të fortë të stereotipeve gjinore në jetën e përditshme, i cili duhet të adresohen duke vendosur përmbajtje që do të promovojnë parimin e barazisë gjinore dhe përfitimet e zhvillimit të një shoqërie të barabartë gjinore;
- supozimet rreth orientimit seksual nxisin komente dhe dënime homofobike, të cilat kanë një ton të dhunshëm dhe priren të nxisin dhe rezultojnë në dhunë, duke treguar një shkallë të lartë të intolerancës ndaj diversitetit në shoqëri. Prandaj, është e nevojshme të nxitet ndërgjegjësimi i publikut për dallimet e identitetit dhe nevojën për gjithëpërfshirje në shoqëri;
- komentet mbështesin ushtrimin e dhunës, veçanërisht dhunës fizike, si masë disiplinore, duke ndikuar kështu në ruajtjen e një kulture të dhunës me bazë gjinore në shoqëri. Prandaj, është e nevojshme të punohet

intensivisht për të rritur ndërgjegjësimin e popullatës së përgjithshme për efektet negative të dhunës me bazë gjinore dhe parandalimin e saj, ku roli i medias është i një rëndësie të veçantë;

- këto narrativa misogyniste, të shprehura kryesisht përmes përmbajtjes keqdashëse dhe gjuhës së urrejtjes me bazë gjinore, mund të kenë një efekt serioz negativ në zhvillimin dhe jetën e mëtejshme të vajzave, por edhe mbi të gjitha gratë dhe vajzat në shoqëri. Për të informuar për efektet negative, por edhe për mënyrën e trajtimit të këtij lloji të përmbajtjes negative, është e nevojshme të punohet në rritjen e ndërgjegjësimin të grave dhe vajzave për këtë fenomen;
- mediat nuk kanë politikë për rregullimin e përmbajtjes negative të komenteve në postimet e tyre, duke kontribuar në përhapjen e narrativeve misogyniste dhe mobilizimin e mbështetjes për përmbajtje shqetësuese dhe krijimin e përmbajtjeve të tilla të reja. Prandaj, është e nevojshme të krijohen politika të brendshme dhe persona përgjegjës për rregullimin e komenteve me përmbajtje negative, në mënyrë që të parandalohet përhapja e mëtejshme e tyre;
- duke marrë parasysh se këto vepra nuk njihen siç në mënyrë përkatëse nga institucionet relevante, as nuk sanksionohen krijuesit e këtyre përmbajtjeve, është e nevojshme të rriten kapacitetet e institucioneve për njohjen dhe trajtimin e duhur në këto raste.



Ky produkt është pregaditur në suaza të proektit “Përdorim i gazetarisë të themeluar ne fakte për ngritjen e vetëdijes dhe kundërshtimit të dezinformacioneve në hapësirat mediatike në Maqedoninë e Veriut “ i finansuar nga Qeveria e Mbretërisë së bashkuar me përkrahje e Ambasadës britaneze në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet të paraqitura në këtë përmbajtje nuk i pasqyrojnë çdoherë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë britaneze.



Институт за
комуникациски
студии

